

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikalastic®-621 TC

VESHJE E LËNGSHME PËRFUNDIMTARE PREJ POLIURETANI ME PERFORMANCË TË LARTË DHE 1 PËRBËRËS PËR SISTEMET E HIDROIZOLIMIT TË TARRACAVE SIKAROOF® MTC



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikalastic®-621 TC është veshje përfundimtare (top coat TC) poliuretani me 1 përbërës, pa bashkime, shumë elastike dhe me rezistencë ndaj rrezatimit UV, aplikohet me metodën e ftohtë dhe përdor teknologjinë e tharjes e cila aktivizohet nga lagështia por nuk ndikohet prej saj, e cila është krijuar për të ofruar aplikim të lehtë dhe një zgjidhje rezistente si pjesë e sistemeve SikaRoof® MTC, si dhe gjithashtu për modifikimin e detajeve të membranave të hidroizolimit të çatave/tarracave.

PËRDORIMET

Sikalastic®-621 TC duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Veshje përfundimtare për SikaRoof® MTC 12,15, 18, 22 në projekte ndërtimesh të reja dhe rikonstrukcione
- Për çati/tarraca me zona detajesh dhe gjeometri komplekse, edhe kur aksesit është i kufizuar
- Për zgjatje me kosto efikase të ciklit të jetës së çatave/tarracave të dëmtuara
- Veshje përfundimtare me reflektivitet të lartë Sikalastic®-621 TC - SR (traffic white RAL 9016) si pjesë e sistemeve Sika SolaRoof™ MTC për karakteristika të shkëlqyera të tarracave/ çatave të ftohta (cool roof) dhe panavele fotovoltaike me 2 faqe.
- Për detajet e membranave hidroizoluese të tarracave / çatave

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Teknologji e provuar - mbi 25 vjet historik aplikimesh
- 1 përbërës - pa përzjerje, lehtësi dhe gati përdorim
- Rezistencë ndaj rrezeve UV - Shumë reflektive (RAL9016) dhe rezistencë ndaj zverdhjes
- Aplikim me metodën e ftohtë - nuk kërkon nxehtësi ose zjarr
- Membranë hidroizolimi tarrace pa bashkime
- Kompatibël me Sika® Reemat Premium - përshtatet mirë në detaje
- Tharje e shpejtë - pa dëmtim nga shiu pothuajse menjëherë në aplikim
- Elasticitet i lartë me mundësi mbylljeje të plasaritjeve - ruan fleksibilitetin edhe në temperatura të ulëta
- Rezistencë e lartë ndaj depërtimit të rrënjëve
- Riveshje e lehtë në rast se nevojitet - nuk kërkohet heqja e membranës së vjetër
- Ndëkapje e mirë mbi shumicën e nënshtresave - shih tabelën e prajmerit
- I përshkueshëm nga avujt e ujit - lejon transpirimin e nënshtresës
- Rezistencë e fuqishme ndaj kimikateve të zakonshme atmosferike

MIRATIME / STANDARDE

Si pjesë e sistemeve SikaRoof® MTC Membranë e lëngshme hidroizolimi sipas ETAG 005, ETA-09/0139 lëshuar nga organi i vlerësimit teknik British Board of Agrément (BBA), mbart markën CE. Deklaratë Performance:

- SikaRoof® MTC 12: 44125185
- SikaRoof® MTC 15: 27265077
- SikaRoof® MTC 18: 15813688
- SikaRoof® MTC 22: 75346978
- Miratim i rezistencës kundër rrënjëve sipas FLL (Instituti i Hortikulturës)
- Reagimi ndaj zjarrit sipas EN 13501-1: Euroclass E
- Performanca ndaj zjarrit të jashtëm sipas EN 13501-5:
- BRoof (t1) - BRoof (t4) (SikaRoof® MTC 15,

nënshtresa jo të djegshme)

- BRoof (t1)- BRoof (t4) (SikaRoof® MTC 18, ndërtim tarracash)
- BRoof (t1) (SikaRoof® MTC 22, ndërtim tarracash)

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	poliuretan alifatik me 1 përbërës me teknologji tharjeje e cila nuk ndikohet nga lagështia	
Ambalazhi	kovë metalike 5 l (~ 7.2 kg) kovë metalike 15 l (~ 21.6 kg)	
Ngjyra	Slate grey (gri e errët) (RAL 7015), shale grey (gri e hapur) (RAL 8500), traffic white (e bardhë) (RAL 9016), ngjyra të tjera me porosi	
Jetëgjatësia	9 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis 0°C dhe +25°C. Temperatura më të larta magazinimi mund të reduktojnë jetëgjatësinë e produktit. Referohuni gjithashtu edhe tek rekomandimet e magazinimit që jepen tek fleta e të dhënave të sigurisë.	
Dendësia	~1.44 kg/l (23 °C)	(EN ISO 2811-1)
Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë	~87.4 % (+23 °C / 50 % lagështi relative)	
Përmbajtja e substancave të ngurta për vëllim	~81.3 % (+23 °C / 50 % lagështi relative)	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca kimike	Spërkatje kripe	1000 orë ekspozim i vazhdueshëm	(ASTM B117)
	Testi Prohesion	1000 orë ekspozim periodik	(ASTM G85-94: Aneksi A5)
	Rezistencë e fortë ndaj shumë lloje reagentësh përfshirë parafinën, benzinën, naftën, white spirit (tretës/ diluent), shiun acid, detergjentët dhe solucione të moderuara acidesh dhe alkalesh. Disa alkoole me peshë molekulare të ulët mund të zbusin materialin. Kontaktoni me shërbimin teknik Sika për informacione specifike.		
Treguesi i reflektimit të rrezatimit diellor	≥ 109*		(ASTM 1980)
	*Te gjitha vlerat i referohen gjendjes fillestare (i tharë, pa ndikim nga kushtet e motit) të Sikalastic®-621 TC në ngjyrë të bardhë (RAL 9016).		
Temperatura e funksionimit	-30 °C min. / +80 °C max.		

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Ju lutemi referohuni tek skedat teknike të sistemeve SikaRoof® MTC
Performanca e sistemit	Ju lutemi referohuni tek skedat teknike të sistemeve SikaRoof® MTC.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +35 °C max.
Lagështia relative e ajrit	5 % min. / 85 % max.
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +60 °C max. ≥3 °C mbi pikën e vesës
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	≤4 % pjesë për peshë përmbajtje lagështie. Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex Pa lagështi rritëse sipas ASTM (fletë polietileni).

Përgatitja e nënshtresës

Ju lutemi referohuni tek skedat teknike të sistemeve SikaRoof® MTC.

Koha e punueshmërisë

Sikalastic®-621 TC është krijuar për tharje të shpejtë. Temperaturat e larta në kombinim me lagështinë e lartë të ajrit do të zgjasin procesin e tharjes. Kështu, materiali në enë të hapur duhet të aplikohet menjëherë. Në enë të hapur, materiali do të formojë cipë pas ~ 1-2 orësh (+20°C/50 % lagështi relative).

Koha e pritjes / mbiveshja

Kushtet e ambientit	Koha min. e pritjes
+5 °C / 50 % lagështi relative	18 orë
+10 °C / 50 % lagështi relative	8 orë
+20 °C / 50 % lagështi relative	6 orë

*Pas 4 ditësh sipërfaqja duhet të pastrohet dhe të lyhet me prajmerin Sika® Reactivation Primer përpara se të vazhdohet më tej. Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Kushtet e ambientit	Rezistenca ndaj shiut	I thatë në prekje	Tharja e plotë
+5°C / 50% lagështi relative	10 minuta*	8-12 orë	16-24 orë
+10°C / 50% lagështi relative	10 minuta*	4 orë	8-12 orë
+20°C / 50% lagështi relative	10 minuta*	3 orë	6-8 orë

* Kini parasysh se ndikimi i rënies së shiut mund të dëmtojë fizikisht membranën ende të lëngshme. Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, me rezistencë të mjaftueshme, e pastër, e thatë dhe pa kontaminues të tjerë. Nënshtresa duhet të lyhet me prajmer ose të pastrohet mekanikisht në varësi të materialit. Mund të nevojitet bluarje për nivelimin e nënshtresës. Nënshtresat e përshtatshme janë: betoni, membranat dhe veshjet bituminoze, metali, tullat, çimento me gëlqere, pllaka qeramike, nënshtresa druri.

Për informacione të detajuara rreth përgatitjes së nënshtresës dhe tabelës së prajmerave, ju lutemi referohuni tek Method Statement No. 850 94 01.

PËRZIERJA

Nuk kërkohet përzierje, megjithatë nëse produkti është ndarë gjatë hapjes, përzieni Sikalastic®-621 TC ngadalë, por plotësisht për të arritur një ngjyrë të njëtrajtshme. Përzierja e ngadaltë do të minimizojë bllokimin e ajrit.

APLIKIMI

Përpara aplikimit të Sikalastic®-621 TC veshja e prajmerit duhet të jetë thatë dhe të mos jetë e ngjithshme. Për kohën e pritjes / mbiveshjen ju lutemi referohuni në skedën teknike të prajmerit të duhur. Zonat e dëmtueshme (parrmakë etj.) duhet të mbrohen me shirit ose mbështjellëse plastike.

Ju lutemi kini parasysh se duhet të filloni gjithmonë me detajet përpara aplikimit mbi sipërfaqen horizontale.

- Aplikoni veshjen e parë të Sikalastic®-601 BC. Punoni deri në pikën në të cilën materiali është mbetët i lëngët*.
- Shtroni Sikalastic® Reemat. Mbivendosni rrjetën Reemat min. 5 cm dhe sigurohuni se mbivendosjet janë mjaftueshëm të lagura për të ngjitur të dyja shtresat.
- Ruli mund të kërkojë vetëm pak material shtesë që të mbetet i lagësht, por nuk duhet shtuar material tjetër në këtë fazë.
- Pasi veshja të jetë mjaftueshëm e thatë për të ecur përsipër, izoloni zonën e çatisë/tarracës me një veshje të dytë Sikalastic®-621 TC.
- Për SikaRoof MTC 22 aplikoni një veshje të tretë Sikalastic®-621 TC.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Thinner S menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose i thatë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Për informacione të detajuara rreth përgatitjes së nënshtresës, tabelës së prajmerave dhe metodën e aplikimit, ju lutemi referohuni tek Method Statement të sistemeve SikaRoof® MTC Nr. 850 94 01.

KUFIZIME

- Mos aplikoni Sikalastic®-621 TC mbi nënshtresa me lagështi në rritje.
- Sikalastic®-621 TC nuk është i përshtatshëm për prezencë të përhershme nën ujë.
- Mbi nënshtresa që ka gjasa të çlirohet gaz, aplikoni gjatë rënies së temperaturës së ambientit dhe nënshtresës. Nëse aplikohet në temperatura në rritje, mund të shfaqen flluska ajri nga ajri i bllokuar.
- Mos holloni Sikalastic®-621 TC me asnjë tretës.
- Mos përdorni Sikalastic®-621 TC për aplikime në mjedise të brendshme.
- Mos aplikoni pranë tubacionit të ajrit të kondicionerëve në funksionim e sipër.
- Mos aplikoni Sikalastic®-621 TC direkt mbi panelet Sikalastic® Insulation. Përdorni Sikalastic® Carrier ndërmjet panelit Sikalastic® Insulation dhe Sikalastic®-621 TC.
- Materialet bituminoze fluore (volatile) mund të njollosin dhe/ose zbusin veshjen.
- Zonat me lëvizshmëri të lartë, nënshtresat e çrregullta apo sipërfaqet e tarracave prej druri kërkojnë një shtresë të plotë Sikalastic® Carrier.
- Mos aplikoni mbi produkte me bazë çimentoje (p.sh. llaç pllakash) direkt mbi Sikalastic®-621 TC.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikalastic®-621 TC

Shkurt 2019, Botimi 04.01

020915205000000007

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42/CE, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / i lloji sb) është 600/500 g/l (Kufizimet 2007 / 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikalastic®-621 TC është <500 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikalastic-621TC-sq-AL-(02-2019)-4-1.pdf



BUILDING TRUST